**UDHËZIM**
**Nr. 5, datë 17.7.2026**

**PËR MIRATIMIN E FORMATEVE TË RAPORTIMIT PERIODIK, TË PLANIT VJETOR TË PUNËS, TË VEPRIMTARISË MINERARE TË SHFRYTËZIMIT**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 23, të nenit 36, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
**Objekti**

Ky udhëzim ka për objekt miratimin e formateve dhe procedurave, të cilat zbatohen nga zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, për:

a) raportimin periodik gjashtëmujor dhe vjetor të veprimtarisë minerare;

b) paraqitjen dhe miratimin e planit vjetor të punës.

Neni 2
**Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen ndaj zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, të cilët janë pajisur me leje minerare nga ministri përgjegjës për sektorin minerar, në përputhje me legjislacionin minerar në fuqi.

Neni 3
**Informacioni i gjashtëmujorit të parë**

1. Informacioni i gjashtëmujorit të parë të veprimtarisë minerare, i paraqitur nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit, përmban:

a) të dhënat e shoqërisë dhe të lejes minerare, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 pjesë e këtij udhëzimi;

b) treguesit e realizuar, sipas formatit të parashikuar në aneksin 2 pjesë e këtij udhëzimi.

2. Informacioni për këtë periudhë dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se data 15 e muajit kalendarik pasardhës, pas mbylljes së periudhës gjashtëmujore.

Neni 4
**Informacioni vjetor**

1. Informacioni vjetor i veprimtarisë minerare, i paraqitur nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit, përfshin:

a) të dhënat e shoqërisë dhe të lejes minerare, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 të këtij udhëzimi;

b) treguesit e realizuar, sipas formatit të parashikuar në aneksin 2, pjesë e këtij udhëzimi;

c) formati për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave, sipas formatit të parashikuar në aneksin 4, pjesë e këtij udhëzimi;

ç) dokumentacionin sipas listës së parashikuar në aneksin 5, pjesë e këtij udhëzimi.

2. Informacioni vjetor dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë AKBN-së, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e vitit kalendarik.

3. Kur struktura përgjegjëse konstaton mosplotësimin e plotë e të saktë ose vendosjen e të dhënave joreale në formatin e raportimit vjetor, sipas anekseve përkatëse të këtij udhëzimi, ia kthen raportimin subjektit për plotësim ose korrigjim.

4. Subjekti, të cilit i kthehet raportimi, detyrohet të plotësojë ose korrigjojë mangësitë e konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e kthimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi përbën shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë.

Neni 5

**Plani vjetor i punës**

1. Plani vjetor i punës hartohet dhe dorëzohet sipas formatit dhe dokumentacionit të parashikuara në aneksin 6, pjesë e këtij udhëzimi.

2. Të gjitha punimet minerare të hapjes, si dhe metodikat e përgatitjes dhe të shfrytëzimit, për vitin raportues e për vitin vijues, duhet të jenë në përputhje me projektin teknik të miratuar në Këshillin Teknik të AKBN-së.

3. Aplikimi dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së aktmiratimit të lejes minerare të caktuar nga ministri. Përjashtim nga ky parashikim bëjnë lejet e parashikuara në nenin 6, pjesë e këtij udhëzimi.

4. Kur struktura përgjegjëse konstaton mosplotësimin e plotë e të saktë të aplikimit për miratimin e planit vjetor të punës, sipas aneksit 6 pjesë e këtij udhëzimi, kërkon plotësimin ose korrigjimin e mangësive të konstatuara.

5. Subjekti, të cilit i kërkohet plotësimi, detyrohet të plotësojë ose korrigjojë dokumentacionin me mangësitë e konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al. Në rast mosmiratimi në kohë të planit vjetor të punës për mosplotësim të mangësive të konstatuara sipas afatit më sipër, AKBN-ja njofton subjektin, ministrinë dhe AKSEM-in. Rifillimi i veprimtarisë minerare lejohet vetëm pas miratimit të planit vjetor të punës.

6. Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga njoftimi i pezullimit subjekti nuk paraqet aplikimin për miratimin e planit vjetor, AKBN-ja propozon masën administrative.

Neni 6

**Plani vjetor i punës për lejet që shtrihen në një plan në kuota të ndryshme**

1. Për lejet minerare që janë pjesë të zonave: zona Bulqizë, zona Batër, zona Tërnove, zona Lugu i Gjatë, zona Thekën dhe zona Krastë, si dhe kudo tjetër që shtrihen në një plan në kuota të ndryshme, plani vjetor i punës hartohet për vitin kalendarik 1 janar–31 dhjetor.

2. Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës janë në përputhje me parashikimet e nenit 5 të këtij udhëzimi.

3. Materiali grafik i planit vjetor realizohet në formatin vektorial 3D (AutoCAD ose ArcGIS), me të njëjtin sistem projeksioni të koordinatave për subjektet e licencuara në të njëjtin vendburim.

4. Plani vjetor i punës dorëzohet nëpërmjet portalit: raport.akbn.gov.al, pranë AKBN-së, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para përfundimit të vitit kalendarik.

5. Struktura përkatëse e AKBN-së shqyrton njëkohësisht materialet grafike të planeve vjetore të subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në të njëjtin vendburim dhe kanë kufij të përbashkët horizontalisht ose vertikalisht.

Neni 7

**Veprimtaria e pezulluar**

1. Subjektet me pezullim të përkohshëm të miratuar nga ministri, sipas pikës 2/1, të nenit 18 dhe 25, ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me afat mbi një vit, nuk përjashtohen nga detyrimi për raportim.

2. Në raportin teknik narrativ, subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përshkruajnë punimet e mirëmbajtjes, të realizuara dhe ato të parashikuara deri në rinisjen e veprimtarisë.

3. Jo më vonë se një muaj para rifillimit të veprimtarisë, subjekti minerar paraqet aplikimin me dokumentacionin e plotë, sipas aneksit 6 pjesë e këtij udhëzimi.

4. Kur plani vjetor i punës për subjektet me pezullim të përkohshëm të miratuar nga ministri miratohet para datës së parashikuar sipas neneve 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, ai miratohet për periudhën e mbetur deri në datën e miratimit të planit të ardhshëm. Tarifa e miratimit nuk paguhet, duke u njohur tarifa e paguar gjatë periudhës së pezullimit.

Neni 8

**Raporti përmbledhës për ministrinë**

1. Struktura përgjegjëse (AKBN-ja) dorëzon pranë ministrisë raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet minerare të shfrytëzimit, brenda afateve të mëposhtme:

a) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga mbyllja e gjashtëmujorit të parë, për raportin gjashtëmujor;

b) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga mbyllja e vitit kalendarik, për raportin vjetor.

2. Raporti i parashikuar në pikën 1 të këtij neni përmban të dhëna, mbi:

a) realizimin e prodhimit;

b) vlerën dhe specifikimet për çdo zë të investimeve të realizuara;

c) respektimin e projektit minerar, frontet ku është ushtruar veprimtaria dhe punimet e reja minerare të kryera, në përputhje me projektin minerar dhe planin vjetor të punës;

ç) bilancin e rezervave minerare;

d) sipërfaqet e prekura nga aktiviteti minerar;

dh) sipërfaqet e rehabilituara dhe sasinë e mbetjeve minerare të depozituara;

e) kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar.

Neni 9

**Aksesi në portal dhe detyrimet e raportimit elektronik**

1. Zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit pajisen me llogari aksesi (emër përdoruesi dhe fjalëkalim) në portalin: raport.akbn.gov.al. Kërkesa paraqitet me shkrim nga administratori i shoqërisë, sipas formatit të parashikuar në aneksin 1 pjesë e këtij udhëzimi.

2. Mungesa e llogarisë së aksesit sipas pikës 1 të këtij neni sjell pasojat e mosraportimit dhe zbatimin e masave administrative, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

3. Në rast pamundësie teknike të dokumentuar apo mosfunksionim të portalit për kryerjen e raportimeve, subjektet minerare i dorëzojnë ato brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar, pranë AKBN-së.

4. Të dhënat e raportuara nëpërmjet portalit të AKBN-së kanë për qëllim përcaktimin e treguesve teknologjikë të mirëshfrytëzimit të rezervave minerare dhe prodhimin e statistikave të nevojshme për shtetin shqiptar.

Neni 10

**Grupimi i mineraleve për raportim statistikor**

1. Mineralet grupohen për raportim statistikor, në përputhje me kërkesat e INSTAT-it dhe EUROSTAT-it, sipas listës së mineraleve të parashikuar në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 11

**Detyrimet institucionale dhe mbikëqyrja**

1. AKBN-ja njofton të gjithë zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit dhe i trajnon ata mbi mënyrën e plotësimit të formularëve e të kryerjes së raportimeve nëpërmjet portalit, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

2. AKBN-ja vendos dhe propozon masat administrative pranë ministrisë për çdo subjekt minerar, në çdo rast mosrespektimi të përcaktimeve të këtij udhëzimi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. AKBN-ja, si institucioni i ngarkuar me zbatimin e këtij udhëzimi, përcakton sektorët dhe njësitë përkatëse të saj për përmbushjen e detyrimeve, sipas kompetencave të tij.

4. Drejtoria përgjegjëse e ministrisë mbikëqyr zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 12

**Shfuqizimi**

Urdhri nr. 201, datë 20.6.2016, "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore" dhe urdhri nr. 202, datë 20.6.2016, "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet", i ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 13

**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS

DHE ENERGJISË
**Enea Karakaçi**

ANEKS 1

FORMATI PËR TË DHËNAT E SHOQËRISË DHE LEJES MINERARE

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | | **Periudha raportuese** | |
| | a | Viti | |
| | b | 1 Gjashtëmujori i parë<br>2 Vjetori | ▼ |
| | | | |
| 2 | | **Të dhëna mbi shoqërinë operuese** | |
| | a | Emri i subjektit sipas QKB-së (zotëruesi i lejes ose nënkontraktori i miratuar nga ministri) | |
| | b | NIPT-i | |
| | c | Adresa e selisë së subjektit | |
| | d | Numër telefoni | |
| | e | Adresë *email*-i | |
| | f | Emër mbiemër i administratorit | |
| | g | Emër mbiemër i drejtuesit teknik | |
| | h | Nr. i licencës së drejtuesit teknik | |
| | i | Investimet me kapital: | |
| | | 1 vendas<br>2 të huaj<br>3 vendas dhe të huaj | ▼ |
| | | | |
| 3 | | **Identifikimi i lejes minerare** | |
| | a | Nr. i lejes (nr. i aktmiratimit nga ministri) | |
| | b | Data e lejes (data në aktmiratim) | |
| | c | Lloji i mineralit ose mineraleve për të cilin është dhënë leja minerare e shfrytëzimit | |
| | | 1 Mineral 1: | |
| | | 2 Mineral 2: | |
| | | 3 Mineral 3: | |
| | d | Emërtimi i vendburimit (dhe kur ka disa leje apo nënkontraktor në një vendburim edhe emërtimi i pjesës ku ndodhet zona minerare e pjesës në administrim) | |
| | e | Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti | |
| | | | |
| 4 | | Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare | |
| | a | Subjektit zotërues i lejes | |
| | b | NIPT-i | |
| | c | Emër mbiemër i administratorit | |
| | e | Adresa e selisë së subjektit | |
| | f | Adresë *email*-i | |

ANEKS 2

FORMATI PËR TREGUESIT E REALIZUAR: (PËR 6-MUJORIN E PARË DHE VJETOR, PËR RAPORTIMIN VJETOR PLOTËSOHEN EDHE TABELAT NË VIJIM)

| Nr. | | Emërtimi | Njësia | Kapaciteti vjetor i miratuar | Realizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | K | Kapaciteti vjetor i miratuar në lejen minerare | ton / $m^3$ ▼ | | |
| 2 | a | Prodhimi minerar në total Tregues = K (konvertuar në ton), realizimi S (a1+a2+a3+...) | ton | | |
| | a1 | Sasia e produktit të mineralit 1 | ton | | |
| | | Cilësia e produktit 1 | % | | |
| | | Pesha volumore e mineralit 1 (produkt i shitshëm) | ton/$m^3$ | | |
| | a2 | Sasia e produktit të mineralit 2 | ton | | |
| | | Cilësia produktit 2 | % | | |
| | | Pesha volumore e mineralit 2 (produkt i shitshëm) | ton/$m^3$ | | |
| | a3 | Sasia e produktit të mineralit 3 | ton | | |
| | | Cilësia produktit 3 | % | | |
| | | Pesha volumore e mineralit 3 (produkt i shitshëm) | ton/$m^3$ | | |
| | a4 | etj. | ton | | |
| | | ..... | % | | |
| | | ..... | ton/m3 | | |
| | b | Nënproduktet e përpunuara<br>Koncentrat ose Inerte të klasifikuara | | | |
| | b1 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| | b2 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| | b3 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| 3 | c | **Sasia e produkteve minerare të shitura në total S (c1+c2), në të njëjtën monedhë** | ton | | |
| | c* | Vlera e produkteve minerare të shitura në total S (c1*+c2*), në të njëjtën monedhë | Vlera | | |
| | c1 | Sasia produkteve minerare të shitura në vend | ton | | |
| | | Çmimi mesatar i shitjes në vend | Lek/ton | | |
| | c1* | Vlera e produkteve minerare të shitura në vend | Lekë | | |
| | c2 | Sasia e produkteve minerare të eksportuara | ton | | |
| | | Çmimi mesatar i shitjes në eksport | Lek/ton | | |
| | c2* | Vlera e produkteve minerare të eksportuara | Lekë | | |
| | | Pagesa e rentës minerare | Leke | | |
| 4 | d | **Investimet në natyrë (punime minerare të kryera)** | | | |
| | | Punime kapitale | ml | | |
| | | Punime përgatitore ose kërkimi | ml | | |
| | | Shpime gjeologjike | ml | | |
| | | Transhe, rrugë | ml | | |
| | | Sheshe | $m^2$ | | |
| | | Zbulim në karriera | $m^3$ | | |
| | | Depozitim sterilesh (punimesh nëntokësore ose zbulimi në karriera) | $m^3$ | | |
| | | **Investimet në vlerë S (d1+d2+d3)** | Lekë | | |
| | d1 | Punime minerare të kryera | Lekë | | |
| | d2 | Rilevime dhe projektime | Lekë | | |
| | d3 | Makineri e pajisje dhe ndërtim montime | Lekë | | |
| 5 | | Fuqia punëtore në total | Nr. | | |
| 6 | | Fuqia punëtore me sigurim jete | Nr. | | |
| 7 | | Pagesa e garancisë se rehabilitimit (vjetore) | Lekë | | |

Administratori i shoqërisë

_____

*Emër, mbiemër, firmë*

Vula:
Vendi dhe data:

Shënim. Vetëm për raportimin vjetor, plotësohen tabelat sipas përcaktimeve:
Për subjektet që shesin tek të tretet mineral ose fraksione të tij vetëm nga leja në zotërim vetëm tabelën 1.
Për subjektet që shesin tek të tretet koncentrat, tabela 1 dhe tabela 2.
Për subjektet që shesin tek të tretët produkt ndryshe nga minerali dhe koncentrati (p.sh. çimento, ferrokrom etj.), por furnizohen me lëndë të parë nga minerali i shfrytëzuar nga lejet e tyre minerare vetëm tabelën 2.

## Tabela 1. Përmbledhëse e shitjeve (janar–dhjetor) mbështetur tek faturat tatimore të shitjeve.

| Nr. | Muaji | Emërtimi | Njësia e | Sasia | Çmimi mesatar | Vlefta me |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | (përshkrimi) i mallit | matjes | | për njësi me TVSH (lek/ton) | TVSH (lek) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | *Produkt ose nënprodukt 1* | | | | |
| | | *Produkt ose nënprodukt 2* | | | | |
| | | . | | | | |
| . | . | | | | | |
| . | . | | | | | |
| 12 | Dhjetor | *Produkt ose nënprodukt 1* | | | | |
| | | *Produkt ose nënprodukt 2* | | | | |
| | | . | | | | |
| Shuma sasia à | | | | | Shuma vlefta à | |

Administratori i shoqërisë

_____

*Emër, mbiemër, firmë*

Vula:

Vendi dhe data:

**Tabela 2. Përmbledhëse e furnizimit me mineral (janar–dhjetor) të fabrikës ose uzinës, mbështetur tek faturat e shoqërimit të mallit**

| Nr. | Muaji | Njësia e matjes | Sasia nga prodhimi nga lejet që zotëron (ton) | Cilësia (% ) | Sasia nga blerjet tek të tretët (ton) | Cilësia (% ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | | | | | |
| . | . | | | | | |
| . | . | | | | | |
| 12 | Dhjetor | | | | | |
| Shuma për sasinë - dhe cilësia e ponderuar | | | | | | |

Administratori i shoqërisë

_____

*Emër, mbiemër, firmë*

Vula:

Vendi dhe data:

**Tabela 3. Gjendje minerali dhe nënprodukte në stok në sheshin e minierës në fund të muajit dhjetor të vitit që mbyllet.**

| Nr. | Emërtimi | Koment me emërtimin e sakte të produktit | Njësia e matjes | Sasia | Cilësia |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mineral 1 | | ton | | |
| 2 | Nënprodukt 1 | | ton | | |
| 3 | Nënprodukt 2 | | ton | | |
| . | .... | | | | |

ANEKS 3

PARASHIKIMI I TREGUESVE KRYESORE TË PRODHIMIT PËR VITIN NË VIJIM

| Nr. | | Emërtimi | Njësia | Parashikimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjashtëmujori i parë | Vjetori |
| 1 | a | Prodhimi minerar në total (konvertuar në ton), realizimi S ($a_1+a_2+a_3+$ ..... $a_n$.) | ton | | |
| | $a_1$ | Sasia e produktit të mineralit 1 | ton | | |
| | | Cilësia e produktit 1 | % | | |
| | $a_2$ | Sasia e produktit të mineralit 2 | ton | | |
| | | Cilësia produktit 2 | % | | |
| | $a_3$ | Sasia e produktit të mineralit 3 | ton | | |
| | | Cilësia produktit 3 | % | | |
| | $a_n$ | etj. | | | |
| | | ..... | | | |
| | | ..... | | | |
| | b | Nënproduktet e përpunuara<br>Koncentrat ose inerte të klasifikuara | | | |
| | b1 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| | b2 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| | b3 | Sasia | ton | | |
| | | Cilësi | % | | |
| 2 | c | Investimet në natyrë (punime minerare) | | | |
| | | Punime kapitale | ml | | |
| | | Punime përgatitorë ose kërkimi | ml | | |
| | | Shpime gjeologjike | ml | | |
| | | Transhe, rrugë | ml | | |
| | | Sheshe | $m^2$ | | |
| | | Zbulim në karriera | $m^3$ | | |
| | d | Investime në projektim dhe makineri pajisje | | | |
| | | Rilevime dhe projektime | Lekë | | |
| | | Makineri e pajisje dhe ndërtim montime | Lekë | | |

ANEKS 4

FORMATI PËR GJENDJEN DHE LËVIZJEN E REZERVAVE

| Nr. | Lloji dhe kategoria e rezervave | | Sasia | | Cilësia | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Njësitë à | | ton<br>$m^3$ | ▼ | %<br>gr/ton | ▼ |
| 2 | Rezervat e nxjerrshme, dhënë në lejen minerare | | | | | |
| 3 | Rezerva të shfrytëzuara nga data e marrjes së lejes minerare | | | | | |
| 4 | Rezervat e nxjerrshme gjendja në fillim të vitit raportues | | | | | |
| | a1 | Rezervat e shfrytëzuara gjatë vitit raportues | | | | |
| | a2 | Rezervat e shtuara deri fund të vitit raportues<br>(vërtetuar me punime kërkim-zbulimi të dokumentuara) | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5** | Rezervat gjeologjike të nxjerrshme gjendje në fund të vitit raportues: nga këto: (4-a1+a2) = (b1+b2+b3) | | | |
| | b1 | Rezerva të hapura (ka shkuar punimi kapital deri tek trupat, traverbank galeri, rampe, dishanderi etj., për nëntokë dhe është ndërtuar transheja apo rruga kryesore deri në nivelin e fillimit të shfrytëzimit për karrierat) | | |
| | b2 | Rezerva të përgatitura (janë hapur punimet e katit (nivelet) për nëntokë, dhe janë ndërtuar rrugët hyrëse për shkallët sipas projektit për karrierat) | | |
| | b3 | Rezerva të gatshme (janë hapur punimet e bllokut dhe kanë filluar nënkatet për nëntokë, dhe janë ndërtuar sheshet e shfrytëzimi në shkallët sipas projektit në karrierat) | | |

ANEKS 5

**Dokumentacioni që duhet të plotësohet dhe ngarkohet krahas plotësimit të anekseve 1, 2, në portalin: raport.akbn.gov.al, për raportimin vjetor të aktivitetit**

1. Mandat pagesa e garancisë së rehabilitimit për vitin që mbyllet, sipas formularit të lëshuar nga zyra përkatëse në ministrinë e linjës.
2. Tabelat në vijim të aneksit 2 (tabelat 1, 2 dhe 3) (të firmosura dhe vulosura).
3. Aneksi 3 (firmosur dhe vulosur).
4. Aneksi 4 (firmosur dhe vulosur).
5. Mandatpagesat e rentës minerare.
6. Mandatpagesat e taksave lokale për vitin që mbyllet, sipas përcaktimit në formularin e njësisë vendore ku kryhet aktiviteti.
7. Vërtetim nga tatim taksat mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore (renta minerare).

---

ANEKS 6

**Dokumentacioni që duhet të plotësohet dhe ngarkohet në portalin: raport.akbn.gov.al, për aplikimin për miratim të planit vjetor të punës.**

1. Raporti teknik i punës së kryer, punimet minerare dhe shfrytëzimi i mineralit, për vitin që mbyllet dhe parashikimi i punimeve minerare dhe të shfrytëzimit për vitin në vijim.
2. Dokumente teknike (planimetri, prerje, etj.).
3. Autorizimi për punë me LP.
4. Licenca e drejtuesit teknik.
5. Kontrata e punës me drejtuesin teknik.
6. Formulari Esig-03 (për drejtuesin teknik).
7. Mandatpagesa e garancisë së rehabilitimit.
8. Mandatpagesa e tarifës së shqyrtimit të planit vjetor të punës.

Shënim. Materialet që ngarkohen në portal vendosen në dosje dhe paraqiten në strukturën e caktuar nga AKBN-ja për trajtimin e tyre.

Përshkrimi i përmbajtjes së raportit teknik.

1. Pjesa prezantuese dhe informuese.

Raporti fillon me të dhënat e shoqërisë dhe lejes minerare të përcaktuara sipas formatit në aneksin 1, vazhdohet me tabelën e treguesve të realizuar për vitin kalendarik të mbyllur (tabela që është plotësuar në raportimin vjetor sipas aneksit 2), më pas vendoset tabela me parashikimin e treguesve kryesore të prodhimit për vitin në vijim (aneksi 3) dhe në vijim të tyre plotësohet tabela me treguesit e prodhimit dhe shitjeve të realizuara nga muaji janar deri në muajin e mbyllur para datës së aplikimit, si në modelin e tabelës, më poshtë:

| Nr. | Muaji | Prodhim Minerali (ton) | Cilësia (%) | Prodhim Koncentrati (ton) | Cilësia (%) | Shitje minerali ose nënproduktesh të tij (ton) | Shitje koncentrati (ton) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | | | | | | |
| 2 | Shkurt | | | | | | |
| 3 | Mars | | | | | | |
| 4 | . | | | | | | |
| 5 | . | | | | | | |
| 6 | . | | | | | | |
| 7 | . | | | | | | |
| 8 | . | | | | | | |
| 9 | . | | | | | | |
| 10 | . | | | | | | |
| 11 | Nëntor | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | | |

P.sh. subjekti që aplikon me 22 korrik, e plotëson tabelën nga janari deri në qershor.

2. Informacioni gjeologjik dhe rezervat e mineralit.

Përgatitet një relacion i shkurtër gjeologjik me të dhëna të përmbledhura saktë për emërtimet e mineralizimit dhe shkëmbinjve rrethues të vendburimit. Kur ka zhvillim të punimeve të reja gjeologjike, ato paraqiten në detaje. Sipas metodikave e teknikave gjeologjike, kur shtohen rezervat jepen me tabelë të dhënat për punimet e kryera, sipas llojit të tyre, kanale, pusëza, shpime, galeri. Po ashtu ndërtohen tabelat përkatëse për rezervat e shtuara me treguesit sasior e cilësor.

Kjo pjesë mbyllet me tabelën për gjendjen dhe lëvizjen e rezervave (tabela që është plotësuar në raportimin vjetor sipas aneksit 4).

3. Përshkrimi i detajuar i punimeve minerare, si dhe punimet e përgatitjes dhe rrëzimit të mineralit për të gjithë aktivitetin e realizuar gjatë një viti. Llogaritja e sasisë së rezervave të marra për çdo bllok apo trup minerar. Përshkrimi i vendeve nëntokë apo sipërfaqe nga ku kanë dalë sterilet, sasia e tyre dhe venddepozitimi i tyre. Punimet e realizuara për rehabilitimin e mjedisit. Përshkrimet e bëra për sa u përcaktua më lart, të përputhen saktë me paraqitjet respektive të atyre punimeve në materialin grafik.

4. Përshkrimi sqarues i punimeve minerare apo gjeologjike që janë parashikuar, si dhe ato të rrëzimit të mineralit për të gjithë aktivitetin e planifikuar për vitin në vijim. Llogaritja e sasisë së rezervave që do të merren për çdo bllok apo trup minerar. Parashikimi i rehabilitimit për sipërfaqet

ku ka mbaruar aktiviteti minerar apo stoqeve të depozitimit të sterileve që janë mbushur sipas përcaktimeve në projektin e miratuar në këshillin teknik apo rehabilitimin pjesor të tyre në sipërfaqet që nuk ka rrezik dëmtimi nga depozitimet në vijim. Përshkrimi i punimeve minerare, të shfrytëzimit dhe të rehabilitimit të parashikuar, si dhe rezervat që do të shfrytëzohen, të përputhen saktë me paraqitjet respektive të atyre punimeve në materialin grafik.

5. Raporti mbyllet me strukturën e burimeve njerëzore të angazhuar në aktivitetin minerar të lejes përkatëse të shfrytëzimit, si dhe një listë të makinerive, pajisjeve apo linjave të përpunimit që përdoren për realizimin e aktivitetit minerar.

6. Materialin grafik.

a) Planimetria e përgjithshme në shkallë të tillë që të jetë paraqitur i gjithë konturi i lejes minerare sipas koordinatave të miratuar në aktmiratim nga ministri. Në këtë planimetri të paraqiten të gjithë zonat minerare ku është kryer aktiviteti minerar në çdo kohë qoftë duke vendosur brenda çdo zonë ku është kryer aktiviteti minerar, vitin e kryerjes së aktivitetit atje. Për këtë planimetri dhe materiale të tjera grafike që përcaktohen në vijim, punimet e kryera para vitit raportues do të paraqiten me ngjyrë të zezë, punimet e kryera gjatë vitit që raportohet do të paraqiten me ngjyrë të kuqe dhe punimet e planifikuara për vitin në vijim me ngjyrë jeshile. Topografia e zonës se licencuar minerare, paraqitur në planimetritë e materialit grafik do të jetë në saktësinë hartografike: për minierat nëntokësore jo më e vogël se 1:5000 dhe për karrierat jo më e vogël se 1:1000.

b) Planimetritë dhe profilet e punës ku paraqitet aktiviteti minerar i zhvilluar për vitin që u mbyll dhe aktiviteti minerar i parashikuar për vitin në vijim. Shkalla e paraqitjes 1:500 dhe kur është e nevojshme për saktësim të mëtejshëm edhe 1:200.

Në çdo rast do të paraqiten të gjitha punimet ekzistuese (edhe ato që nuk përdoren). Veç punimeve që do të paraqiten me ngjyrat e përcaktuara, do të paraqiten edhe hapësirat e shfrytëzuara me konture të sakta, me vijëzim (*hatch*) me ngjyrat që tregojnë kohën e shfrytëzimit, si edhe tek punimet minerare (e zezë, e kuqe dhe jeshile).

Po ashtu në profile gjithnjë duhet të jenë paraqitur shpimet gjeologjike dhe rezultatet e kapjeve, qoftë nga shpimet apo nga punimet e kërkimit. Kur zona aktive e shfrytëzimit është në mes të profileve normale të përcaktuara që në raportin gjeologjik, përgatiten profile të ndërmjetme plotësuese për të pasur të qartë punimet që mundësojnë aktivitetin në atë zonë.

c) Punimet e kërkimit apo shpime gjeologjike që mund të jenë kryer gjatë vitit pasqyrohen në materialin grafik të punës. Kur punimet apo shpimet gjeologjike janë bërë në një zonë të re të vendburimit, por sigurisht brenda kontureve të lejes, paraqiten në planimetri e profile plotësuese më vete. Në të dyja rastet, bashkë me punimet e hartografuara, reflektohet edhe dokumentimi dhe interpretimi gjeologjik i tyre. Planimetritë duhet të jenë të firmosura nga Ing. gjeolog që i ka ndjekur dhe interpretuar ato.

d) Për minierat sipërfaqësore, paraqiten edhe: pasaporta e shfrytëzimit të miratuar dhe ajo faktike e realizuar për karrierën me elementet e llogaritur të lartësisë së shkallës, gjerësisë së sheshit të shkallës dhe shesheve të punës, pjerrësisë së skarpatës së shkallës, si dhe këndi i shpatit total të karrierës.

e) Për minierat nëntokësore, paraqiten edhe: lloji i ajrimit që përdoret, vizatimi perspektiv (pamje 3D), si dhe skema kanonike e ajrimit të minierës, të përditësuara. Rrugën e hyrjes së ajrit të pastër (me blu), ajrimin e fronteve të punës dhe rrugët e largimit, deri në dalje të ajrit të papastër (me të kuqe). Po ashtu të paraqiten pozicionet e vendosjes së ventilatorëve lokal që janë në përdorim, si dhe pozicioni i vendosjes së ventilatorit qendror. Pasaportat e shpimplasjes dhe armatimit të punimeve minerare. Pasaporta e shfrytëzimit të bllokut. Skema e rrjetit të furnizimit me ajër të ngjeshur. Skema e rrjetit të furnizimit me ujë për shpimin e lagur. Skema e rrjetit të

nxjerrjes se ujërave nëntokësore, si dhe treguesit e cilësisë së ujit që del nga miniera, PH dhe materiali inert pezull në të.